



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2021
Nr. ref.:RK 1783/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI15/20

Parashtrues

Merita Dervishi

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative AA. nr. 557/2019, të 05 nëntorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Merita Dervishi, fshati Kostërc, komuna e Skenderaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës). Parashtruesen e kërkesës e përfaqëson Safet Voca, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, AA. nr. 557/2019, të 5 nëntorit 2019, si dhe kushtetutshmërinë e Njoftimit KMLA. nr. 24/2019, të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të 29 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, përmes të cilave pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për një zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 janar 2020, parashtruesja e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 10 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.
8. Më 12 prill 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomadoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Gjykata në fillim, për shkak të specifikës procedurale të kësaj kërkesë, duhet të rikujtojë që parashtruesja e kërkesës tashmë kishte parashtruar një kërkesë më 24 nëntor 2017 të regjistruar nga Gjykata me numër KI 140/17, në të cilën ajo kishte kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 56/2017] të Gjykatës Supreme të 30 tetorit 2017 në lidhje me aktgjykimin [AA. nr.

56/2017] të Gjykatës së Apelit të 18 korrikut 2017 dhe aktgjykimit [A. nr. 781/2015] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 23 dhjetorit 2016 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

10. Gjykata vëren se substanca e kërkesës KI140/17 kishte të bënte me një kontest të punës kundër Komunës së Skenderaj, të cilin parashtruesja e kërkesës fillimisht e kishte iniciuar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK), i cili përfundoi me vendimin e KPMK [nr. A 02/107/2015], me të cilin ankesa e parashtrueses së kërkesës kundër vendimit të Komunës së Skenderaj ishte refuzuar si e parashtruar jashtë afatit, në pajtim me nenin 130 të Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe nenin 4 të Rregullores për Ankesa.
11. Procedura e dytë u iniciua nga parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore në të cilën ajo e kontestoi vendimin e KPMK-së [nr. A 02/107/2015].
12. Në atë procedurë, së pari Gjykata Themelore më 23 dhjetor 2016, dhe pastaj Gjykata e Apelit më 18 korrik 2017, hodhën poshtë ankesat e parashtrueses së kërkesës si të pabazuara. Parashtruesja parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Më 30 tetor 2017, Gjykata Supreme e refuzoi atë kërkesë si të pabazuar.
13. Parashtruesja e kërkesës më pas pretendoi në Gjykatën Kushtetuese se vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me nenet 24, 31, 32, 49, 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
14. Gjykata konstaton se më 28 maj 2019, Gjykata Kushtetuese nxori Aktvendimin për papranueshmëri në kërkesën KI 140/17.

Përmbledhja e fakteve në rastin KI15/20

15. Në kërkesën KI15/20, Gjykata konstaton se më 3 korrik 2019, avokati i parashtrueses së kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në të cilën ai kërkoi rishqyrtim të procedurës gjyqësore në lëndën A. nr. 781/2015, bazuar në nenin 55.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me arsyetimin: „se me datën „24.06.2019 paditësja ka mësuar, gjegjësisht është informuar se flet kthesa të cilën e ka nënshkruar me datën 09.03.2015 në zyrën e tij të avokatisë në Mitrovicë, nuk i është dërguar fare gjykatës së kësaj çështje, e që në fakt paraqet provën vendimtare se në rastin konkret...“
16. Më 5 korrik 2019, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin A. nr. 781/2015, me të cilin refuzoi kërkesën e avokatit të parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, duke deklaruar:

„nenit 55 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, qe ka marrë formën e prerë” kur: pika 1.1 “pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të

ishin shtuar ose përdorë këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore”, ndërsa në piken 1.2. të po këtij neni përcaktohet se: “vendimi i gjykatës ka ardhë si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprimin mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuarit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse ky veprim përben vepër penale[, pika 1.3 e këtij neni përcakton “vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë”, pika 1.4 përcakton se: “dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë”, pika 1.5 përcakton se: “pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ” dhe pika 1.6 e po këtij neni përcakton se: “personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”. Ndërsa nën paragrafi 2 i nenit 55 përcakton se “Për shkak të rrethanave nga nën-paragrafi 1.1 dhe nën-paragrafi 1.5 i këtij paragrafi rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vet, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana t’i shtrojë në procedurën e mëparshme”. Ndërsa neni 60.2 përcakton se “Gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur, apo pala nuk e ka bërë të paktën të besueshme ekzistimin e bazës ligjore për rishikim”. Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 55 gjykata vlerëson se paditësja, përkatësisht i autorizuari i saj i cili ka marrë pjesë në seancat e mbajtura në këtë gjykatë, ka pasur mundësi që rrethanat, përkatësisht faktet e përmendura në kërkesë për rishikim t’i parashtroj në procedurën e mëparshme të zhvilluar para kësaj gjykate dhe atë gjatë seancave të mbajtura, pastaj gjatë ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit si dhe gjatë ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës...”

17. Brenda afatit ligjor, avokati i parashtrueses së kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkelje të esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, si dhe shkelje të nenit 31, paragrafi 1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së.
18. Më 5 nëntor 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin AA nr. 557/2019, me të cilin refuzoi ankesën e avokatit të parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, duke deklaruar:

“Kolegji i kësaj gjykate e vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, meqë nuk janë plotësuar kushtet e lartcekura ligjore. Po ashtu, kolegji i kësaj gjykate aktvendimin e ankimuar e ka vërtetuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj, nga se vendimi është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale, konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Sa i përket shkeljes së dispozitave të nenit 31 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 6 par. 1 të KEDNJ, ngase paditëses nuk i është mundësuar që çështja të dëgjohet drejtësisht, publikisht, dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor, e sidomos nuk i është mundësuar mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm“.

19. Avokati i parashtrueses së kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit të Kosovës, duke kërkuar që Prokurori i Shtetit të parashtroj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 781/2015 të 5 korrikut 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative AA. nr. 557/2019 i 5 nëntorit 2019, *“sepse në to janë bërë shkelje të dispozitave procedurale dhe gabimisht është zbatuar e drejta materiale, dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 31, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së”*.
20. Më 29 dhjetor 2019, Prokuroria e Shtetit nxori Njoftimin KMLA. nr. 24/2019, në të cilin thuhej:

“Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe analizave gjithëpërfshirëse, si të provave, po ashtu edhe të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, në lidhje me pretendimet e deklaruara në propozimin tuaj për të ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, Zyra e Prokurorit të Shtetit nuk gjeti ndonjë bazë ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Pasi që neni 25 i Ligjit për konfliktet administrative përcakton se kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, prokurori i shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, nëse është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm, dhe është fakt se nuk ka shkelje të tilla në rastin konkret, dhe as nuk ka shkelje të nenit 31, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe kjo është arsyeja për të mos parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit”.

Ligji relevant

LIGJI NR. 03 / L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 55

Rishikimi

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:

1.1 pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;

1.2 vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuesit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën vepër penale;

1.3 vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë;

1.4. dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë;;

1.5 pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ; dhe

1.6. personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

2. Për shkak të rrethanave nga nën-paragrafi 1.1 dhe nën-paragrafi 1.5 i këtij paragrafi rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vet, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana t'i shtrojnë në procedurën e mëparshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon që në procedurën e kryer nga Prokurori i Shtetit ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për një zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, ndërsa me aktvendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë janë shkelur dispozitat e nenit 31, paragrafi 1 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se ekzistojnë dy grupe pretendimesh të bëra nga parashtruesi dhe se ato kanë të bëjnë me i) aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA. nr. 557/2019, si dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore A. nr. 781/2015 dhe ii) me njoftimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit KMLA. nr. 24/2019.

23. Përkitazi me pretendimet në lidhje me aktvendimet e gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës pretendon që *“gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me vendimet e tyre jo ligjore palës ia kanë mohuar të drejtën për një proces të rregullt dhe të drejtë të paraparë me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse dispozitivët e aktvendimeve të gjykatave janë juridikisht të paqarta dhe kundërthënëse në vetvete dhe me arsyetimin e tij, ngase në arsyetim nuk janë dhënë arsye të qëndrueshme dhe ligjërisht të bazuara mbi faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar në nxjerrjen e këtyre aktvendimeve”*.
24. Sa i përket pretendimeve në lidhje me Njoftimin KMLA. nr. 24/2019 të Prokurorit të Shtetit, parashtruesja e kërkesës thekson faktin që Prokurori i Shtetit *“në Informatën e tij KMLA. Nr. 24/2019 të datës 20.12.2019, nuk jep kurfar arsyetimi të bazuar ligjërisht se pse nuk e ka inicuar çështjen në Gjykatën Supreme të Kosovës, por krejt arsyetimin e tij e përmbledh në disa fjali”*. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon *“se Prokurori i Shtetit duke mos e inicuar Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmëris në Gjykatën Supreme të Kosovës palës ia ka mohuar të drejtën e saj kushtetuese të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës lidhur me nenin 13 të KEDNJ.”*
25. Gjykata gjithashtu vëren se në kërkesën e parashtrueses së kërkesës ka edhe pretendime të tjera në lidhje me drejtësinë e vendimeve në një procedurë që tashmë ka përfunduar. Konkretisht, *“gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me vendimet e tyre jo ligjore palës ia kanë mohuar të drejtën për një proces të rregullt dhe të drejtë për faktin se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë është juridikisht i paqartë dhe kundërthënëse në vetvete.”* Po ashtu, ekziston edhe një pjesë e pretendimeve lidhur me provat rreth datës në fletëkthesë që gjithashtu kanë të bëjnë me procedurën tashmë të përfunduar. Duke pasur këtë parasysh, Gjykata thekson se nuk do t'i trajtojë ato në këtë kërkesë, pasi që ato tashmë janë analizuar në kërkesën KI140/17.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Më tej, Gjykata vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

29. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafët (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...]”.

30. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA. nr. 557/2019, të 5 nëntorit 2019, në lidhje me kërkesën e saj për rishqyrtim të procedurës gjyqësore, si dhe njoftimin KMLA. nr.24/2019 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për refuzimin e kërkesës së saj për mbrojtjen e ligjshmërisë.
31. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari konstaton se parashtruesja e kërkesës më 7 shtator 2019 parashtroi në Gjykatën Themelore kërkesën, në të cilën ajo kërkoj rishikimin e procedurës gjyqësore në lëndën A. nr. 781/2015, duke u bazuar në nenin 55.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

32. Gjykata vëren se dispozita ligjore e nenit 55 të Ligjit 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE, parasheh mundësinë e rishikimit të një vendimi, përkatësisht që *Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë*, vetëm atëherë kur plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafët vijues të nenit 55.
33. Gjykata konstaton se së pari Gjykata Themelore, dhe më vonë edhe Gjykata e Apelit në procedurën e apelit në lidhje me kërkesën e parashtrueses për rishikim të procedurës gjyqësore, nxorën aktvendimet me të cilat hodhën poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, duke cituar dispozitat e nenit 55, paragrafi 2, me ç'rast konkluduan se *„Bazuar në dispozitat e cekura me larte, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 55 gjykata vlerëson se paditësja, përkatësisht i autorizuari i saj i cili ka marrë pjesë në seancat e mbajtura në këtë gjykatë, ka pasur mundësi që rrethanat, përkatësisht faktet e përmendura në kërkesë për rishikim t'i parashtroj në procedurën e mëparshme të zhvilluar para kësaj gjykate dhe atë gjatë seancave të mbajtura, pastaj gjatë ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit si dhe gjatë ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës. ...”*
34. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, sipas kërkesës për përsëritje të procedurës gjyqësore të parashtrueses së kërkesës, vendosën ekskluzivisht për përmbushjen e kushteve procedurale për përsëritje të procedurës gjyqësore, dhe jo për meritat e rastit.
35. Gjykata përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
36. Gjykata, duke marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat Gjykata mund t'i shqyrtojë vetëm në lidhje me kërkesën për përsëritje të procedurës gjyqësore, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e saj gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).
37. Në pajtim me këtë, Gjykata konkludon se ankesa e parashtrueses së kërkesës në lidhje me refuzimin e gjykatave të rregullta për iniciimin e procedurës gjyqësore në lidhje me meritat e kërkesës për të cilën tashmë kanë vendosur

nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

38. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e dytë të parashtrueses së kërkesës, se Zyra e Prokurorit të Shtetit ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se është në diskrecion të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të vendos nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ka elemente për t'u pranuar apo jo. Në rastin konkret Gjykata gjen se pas analizës së kërkesës së parashtrueses "*Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka gjetur se ekzistojnë baza ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë*".
39. Rrjedhimisht, Gjykata gjen si të pabazuara pretendimet e parashtrueses së kërkesës se me njoftimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit asaj i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
40. Prandaj, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 12 prill 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Artur Rama-Hajrizi

